REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**
**KËSHILLI I BASHKISË**
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

**Nr.** 1490/1.2 **Prot.** **Patos, më** 28/07 **2023**

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 Korrik 2023**

**Vendi:** *"Njësia Administrative Ruzhdie fshati Gjinoqarë"*

**Ora e fillimit :** ***10:00***

***Ora e mbarimit : 12:30***

**Tema e konsultimit:** **"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"**

**Baza Ligjore:** *Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"neni 18; Ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin Publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52 ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për Konsultimin Publik"*, si dhe VKB-së nr. 94 datë 19.12.2022 Mbi Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe Projekt Buxhetit Vjetor për vitin 2024.

**Pjesëmarrës**: Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë Z. Armand Ahmetaj, Anëtarë të këshillit bashkiak, Sekretare e Këshillit Bashkiak znj. Refaela Xeba Administratore e Njësisë Ruzhdie Agim Mesuti, Deputete e Qarkut Fier znj. Antoneta Dhima, *Koordinatorja e Konsultimit Publik znj.Suzana Hysenaj, dhe Rreth 50 pjesëmarrës (Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të njësisë Administrative Ruzhdie)*


*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

**Takimin hapet nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj**: në radhë të parë më lejoni t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjesë publike. Për ata që nuk më njohin unë jam Armad Ahmetaj Kryetar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë Patos dhe kjo është një dëgjesë publike e cila organizohet nga Këshilli Bashkiak dhe Bashkia. Ju falenderoj të gjithëve që i jeni përgjigjur ftesës sonë për të marrë pjesë në këtë dëgjesë publike tema e së cilës është e miratuar sipas kalendarin vjetor të konsultimeve e miratuar në fillim të vitit. Është kryer një dëgjesë më parë me sa jam informuar, nuk e di nëse keni qenë ose jo të pranishëm dhe tema e këtij takimi të sotëm është "Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"

Pra sic e thashë këshilli dhe bashkia organizojnë këtë proces si një detyrim që buron nga ligji 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore , ligjit nr. 146/2016 për njoftimin dhe konsultimin publik por edhe të Rregullores së Këshillit Bashkiak. Ju kemi ftuar në këtë dëgjesë për të qenë trasparent dhe të drejtëpërdrejtë, për t'ju dëgjuar por edhe për të na dëgjuar në lidhje më cështje të cilat kanë interes publik për gjithë komunitetin e gjithë Njesëisë Administrative Ruzhdie. Ju bëj me dije se të gjitha kërkesat, propozimet apo sygjerimet tuaja do të regjistrohen sipas rregullave të përcaktuara në ligj dhe më pas do të reflektohen në buxhet apo në masa të tjera që bashkia merr më pas kësaj dëgjese. Të gjithë do të keni mundësi të flisni. Duke ju falenderuar edhe një herë po ia kaloj fjalë Kryetarit të Bashkisë



**Kryetar i Këshillit të Bashkisë z. Armand ahmetaj**

***Degjesë publike me temë:***

**"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"**

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro :** përshëndetje ju falenderoj që keni ardhur në këtë takim konsultativ në fshatin Gjinoqar dhe jo pa qëllim kemi zgjedhur këtë fshat duke qenë se është në qendër të njësisë Rauzhdije. Si fillim me qenë se jemi në Gjinoqarë për këtë fshat është parashikuar për investim rruga e qendrës së fshatit Gjinoqarë e cila është futur në buxhet dhe do

të jetë e financuar në dy vite financim 2024-2025 por besoj se punimet do të përfundojnë brenda vitit 2024. Rruga do të ketë edhe mure mbajtës por edhe kanalizim të ujrave të bardha e të zeza. Pra kjo rrugë është  e parshikuar. Gjatë këtij vit kalendarik janë parashikuar shtrimi i disa rrugëve me rërë bituminoze në njësinë administrative Ruzhdie dhe përkatësisht: rruga e Shkëmbit e cila do të ketë ndërhyrje në disa pjesë të saj me shtrim me rërë bituminoze. Rrugë të tjera ku do të ndërhyet janë rruga "Kocomilo", rruga "e gjolit" rruga  "Mshkullorë Visokë" rruga "Kasaj, rruga "Gjynoqarë Ngrecie" rruga "Hyskaj" fundi i rrugës "Xhepaj" dhe një pjesë e rrugëve në fshatin Drenie. Gjithashtu do të bëhet projekti për rrugën "Siqecë Drenie". Duke qenë se është një investim me një kosto totalisht të lartë për buxhetin e bashkisë për këtë projekt do të kërkohet bashkëfinancim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ne do të bëjmë gjithcka që ta arrijmë si investim dhe të jemi përfitues për këtë projekt. Pra ky projekt nuk varet drejtpërdrejtë nga ne pasi faza e parë është ajo e hartmit të projektit dhe më pas do të kërkohet financim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Për pjesën e ujësjellësit aktualisht jemi në fazën e fundit të kalimit në Këshillin teknik mbikqyrës dhe besoj se si procedurë mbyllet këtë vit për të vazhduar me lotin e tretë të ujësjellësit. Aktualisht jemi në lotin e dytë të punimeve, është magjistrali kryesor qe vjen nga fshati Varibob deri në Patos, dhe loti i tretë përfshin komplet njësinë administrative Ruzhdie ku është projektuar edhe një stacion pompimi e cila do të zgjidhë sistemimin e ujit në këtë njësi.

Rruga e fshati Gjynoqarë duke qenë se është edhe projekti i ujësjellësit do të  shohim mundësinë që ata të ndërhyjnë paralelisht me qëllim mos të bëjmë rrugën dhe pastaj ta presim për ujësjellësin sic është situata deri tani besoj se do të arihet pasi do të kërkojmë shtrimin e rrjeti të ujësjellësit pastaj investimin në rrugë. Padiskutim do të vazhdojmë punën për shtrimin e rrugëve të parcelave të atyre ekzistuese por edhe hapjen e rrrugëve të reja. Bashkia aktualisht ka një



**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"



*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

mungesë të theksuar mjetesh teknike sic është eksavatori dhe skrepi ndaj ne për të kryer shërbime do të shohi mundësinë e blerjes së një mjeti ekskavator dhe skrep brenda këtij viti. Doja të dija si e keni situatën me shitjen e vajti të ullirit që mund të keni stok pasi aktualisht janë disa firma italiane të cilat kërkojnë grumbullimin e vajit të ullirit dhe me sa kam parë cmimi që ofrohet prej tyre është me interes për ju pasi shkon nga 500 deri në 550 lekë për litër ndaj nëse keni prodhim stok ata janë të gatshëm pasi nuk kanë kufizime. Lidhur mbi buxhetin unë ju bëra një prezantim të shkurtër për investime në njësinë Ruzhdie tani fjala është për ju.

**Banor i fshatit Gjinoqare z. Besim Muca –** kryetar suksese në punën tuaj por në lagjen Mashkullorë nuk është vendosur dorë fare dhe mbi të gjitha jemi 30 familje që nuk kemi ujë as për të pirë dhe as për vaditje. Të shpohet pus për ujin e pishëm është një fshat që nuk ka një cesëm dhe kemi kërkuar prej vitesh zgjidhjen e ujit për shpimin e një pusi për furnizim me ujë



**Banor i fshatit Gjinoqare z. Besim Muca**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Banor i fshatit Gjynoqarë z. Gramos Laze** – Kemi problem me rrugën e fshatit pasi nuk shkojmë dot në banesat tna është një problem tjetër nuk kemi rrugë për të shkuar te toka bujqësore



**Banor i fshatit Gjynoqarë z. Gramos Laze**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024



*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

**Kryetar i fshatit Kasnicë z. Haxhi Qose-** fshati Kasnicë prej shmë vitesh vuan mungesën e rrugës edhe pse cdo vit është kërkuar ndërhyrje në rrugën kryesore të fshatit asgjë nuk është bërë nga bashkia gjithashtu kemi probleme me rrugët e tokave bujqësore të cilat kërkojnë të hapen ose të pastrohen.

Jemi në mesin e verës dhe një zjarrë po të bjeri nga do të hyjë zjarrfiksja për shuarjen e zjarrit. Shumë afër fshatit është rëra bituminoze dhe fshati Kasnicë nuk ka një rrugë të shtruar as më rërë por vijnë makinat e marrin dhe shtrojnë rrugët e tjera ndërssa fshati jonë jo.



**Kryetar i fshatit Kasnicë z. Haxhi Qose**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Kryetar i fshatit Gjynoqarë z. Nuri Gllava-** kryetar kërkesat tona janë të përsëritura në cdo takim. Fshati Gjynoqarë vuan prej vitesh dëmtimin e rrugës kryesore të fshatit. Problem tjetër është mungesa e ujit të pishëm por derisa të përfundojë projekti i ujësjellësit duhet një zgjidhje alternative pasi jemi 40 familje që vuajmë për ujë. Rrugët e hapura apo ato ekzistuese kanë nevojë emergjente për vendsje të tubinave apo mirëmbajtje apo edhe zgjerim. Problem tjetër që dua të ngre, kur fshati është i madh përse të mos vendosen koshat e plerave është një problem i ngritur prej vitesh nga unë si kryetar fshati



**Kryetar i fshatit Gjynoqarë z. Nuri Gllava**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Banor i fshatit Gjynoqarë z. Seit Arapi** – ju falenderoj që po na respekton dhe ke ardhur për të na dëgjuar hallet tona, jam banor i lagjes Mashkullorë dhe kemi kohë që vuajmë mungesën e rrugës, nuk hyjmë dot në shtëpitë tona. Problemi i ujit të pishëm është shumë emergjent pasi jemi në mesin e verës dhe nuk kemi ujë për të pirë kjo është katastrof pasi një burim që kemi ai nuk ka më ujë ndaj na ndihmoni për ujë.



**Banor i fshatit Gjynoqarë z. Seit Arapi**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Banor i fshati Gjynoqarë z. Belul Mucaj –** problemi jonë kryesor kryetar është mungesa e ujit të pishëm. Rruët që ju përmendët duhet të bëhen. Ne në lagjen Mashkullorë jemi në krizë totale pasi burimi i lagjes ka mbaruar ndaj duhet të shikohet mundësia si nga bashkia dhe si këshilli të bëhet një pusetë apo depo për të grumbulluar ujë ose të shikohet mundësia për shpimin e një pusi për t'u furnizuar popullata me ujë.



**Banor i fshati Gjynoqarë z. Belul Mucaj**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024



*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

**Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Soraj-** edhe vitin e kaluar janë bërë dëgjesa publike ku ju keni ardhur kur them ju bashkia keni ardhur keni mbajtur shënime por zgjidhje nuk iu është dhënë problemeve tona. Fshati Siqecë vuan për mungesën e ujit të pishëm . Kemi probleme me pjesën e azhornimit të tokave bujqësore pasi nuk marrim dot certifikatën e pronës. Kemi problem me rrugën në lagjen Xhepaj e cila kërkon ndërhyrje emergjente pasi banorët nuk shkojnë dot në shtëpitë e tyre. Dihet se në fshat ka një mungesë të theksuar të prezencës së mjekut dhe kërkojmë që mjeku të vij të paktën dy herë në javë për dhënien e shërbimit pasi ka të moshuar që nuk kanë me se të lëvizin.



**Kryetar i fshatit Siqecë z. Myftar Soraj-**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Banor i fshatit Gjynoqarë z. Ladimir Mucaj** – ju dëgjova me vëmendje kryetar lidhur mbi projektet që përmende për lagjen Mashkullirë dhe padiskutim që janë parësore por ne si banorë sot për sot këmi problemin e ujit të pshëm. Të krijohet mundësia e furnizimit me autobote pasi në në fshatra ka familje të mëdha me 12 ose 13 pjesatarë. Mendimi që u hodh për shpim pusi është një mendim i mirë për sot ju nuk e bëni dot. Sot për sot problemi kryesorë është uji na ndihmoni



**Banor i fshatit Gjynoqarë z. Ladimir Mucaj**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024



*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

të paktën gjatë gushtit për ujë pasi Fieri është shënuar si zonë e kuqë për zjarret. Ke mundësi të na sjellës ujë me autobote të aktën për familjet që janë me shumë frymë

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro :** nëse e sjellim ujin me autobote nga Grecia a kemi ne një pikë ku të shkoj autoboti?

**Banor i fshatit Gjinoqarë z. Besim Muco –** në Grecie ka ujë pafund 500 metër largë është mund ta sjellësh duke shtruar edhe tubat plastik për të na furnizuar me ujë



**Banor i fshatit Gjinoqarë z. Besim Muco**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro : Grecia si e ka ujin me orar?**

**Banor i fshatit Gjinoqarë z. Besim Muco –** pa orar e kanë ujin ose një mundësi tjetër është a bie dot në ujdi me Sadikun pasi ai ka hapur një pus ku ka ujë me qëllim shtrimin e tubove provizore qoftë edhe ta paguajmë

**Banor i fshati Gjynoqarë z. Qerem Muca –** problemi i ujit të pishëm nuk është vetëm për fshatin tonë por për të gjithë njësinë, kryetar gjeni mundësinë për të na ndihmuar për ujin e pishëm pasi jemi në mesin e thatësirës.



**Banor i fshati Gjynoqarë z. Qerem Muca**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024



*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

**Kryetari i fshatit Ruzhdie z.Sako Myftaraj** – Kryetar fshati ka shumë probleme por sic dhe po e shikon problemi jonë kryesor është uji ju lutem gjeni mundësinë të na ndihmoni në keto ditë të veshtira qofte edhe nëse shtroni tubo provizore nga grecia qofte nëse na mundësoni sjelljen e boteve me ujë apo edhe nëse negocioni me Sadikun për të na lejuar te marrim ujë pasi është pronë private dhe ne nuk mund të hyjmë



**Kryetari i fshatit Ruzhdie**
**z.Sako Myftaraj**

Degjesë publike me temë:

"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro :** zgjidhje përfundimtare patjetër që është ujësjellësi që edhe në qofë se nuk duam ne projekti është i till që faza e dytë e ujësjellësit në momentin që përfundon ngelen tre fshatra pa ujë. Furnizimi i këtyre tre fshatrave njëri prej tyre është edhe fshati Kasnica, është i parashikuar në fillimin e lotit te tretë të ujësjellësit dhe për të zgjidhur këtë emergjencë ne do të shohim mundësinë e sjelljes së autobotit për furnizim me ujë. Nuk mund të them se ai autobot do të shpërndajë ujë në cdo familje pasi edhe terreni është i tillë që nuk na e mundëson shpërndarjen në cdo banesë por ku të ketë mundësi do të shpërndaje dhe furnizimi me ujë. Lidhur mbi propozimin tuaj për hapjen e puseve nuk e di se si është si zonë nëse ka burime



**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro :**

***Degjesë publike me temë:***

**"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"**


*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

nëntokësore për ujë ndaj si fillim duhet ti drejtohemi agjencisë për të na informuar se ku ka burime nëntokësore për të parë se ku ka shtresa nënujore por pusi edhe po të duam nuk shpohet sot për të kaluar këtë emergjencë për këtë vit pasi vetëm procedura që duhet të bëj bashkia për hapje pusi zgjasin dy deri në tre javë por ne do ti japim zgjidhje problemit me sjelljen e boteve të ujit dhe kjo do të jetë një zgjidhje provizore.

Nuk e di nese keni ndonjë kërkesë tjetër lidhur mbi kërkesat buxhetore? Me qenë se jo përapara se ta mbyllim këtë takim më lejoni të bëj një njoftim marrë shkasë edhe nga situata dhe temperaturat e larta kërkoj bashkëpunimin tuaj për parandalimin e fzjarrrëvenieve në parcelat hambullore si dhe cdo lloj toke. Në rast se vëreni dikë ose diku rënie zjarri njoftoni në numtar e kontaktit të cilat janë të publikuara edhe në faqen zyrtare t bashkisë, kryetarin e fshatit apo administratorin. Unë ju falenderoj edhe një herë për pjesëmarrjen tuaj

**Konceptoi:**
**Koordinator i Konsultimit Publik**
Suzana **Hysenaj**

**Pranoi:**
**Sekretar i Këshillit**
Refaela Xeba


*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

Foto të dëgjesës publike me temë: **"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"**





*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*




*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*









*Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**

**KOORDINATOR I KONUSLTIMIT PUBLIK**

**Nr.** 1491 **Prot.** **Patos, më** 20/06/ **2023**

1

**NJOFTIM**

**Dëgjesë publike me temë: "Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024"**

Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 4 neni 52; *Ligjit* Nr. *119*/2014 "Për Të Drejtën E Informimit" Rregullores së Këshilli Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB-së nr. 94 datë 19.12.2022 mbi "Miratimin e kalendarit të përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe Prjekt Buxhetit Vjetor për vitin 2024"

**Ju njoftojmë se:**

Ditën e **Martë** më datë **25.07.2023, ora 10:⁰⁰**, në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, do të organizohet takimi konultatliv me përfaqësues të: Kryesisë së fshatrave, banorë të qytetit dhe grupe interesi, lidhur mbi "**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024**"

***Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimitn e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.***

**KRYETARI**

**Fatjon Duro**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PATOS

Ruzhdie më, 21.07.2023

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PATOS**

**LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:**

**RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026" DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024"**

| Nr | Emër Mbiemër | Qyteti / Fshati | Profesioni/ Pozicion | Nr. Kontakti | Firma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Floruda Aleksmonaj | Patos | Këshilltare | 0693226915 | |
| 2 | ADRIANO ALIAJ | DRENIE | INXHINIER | 0698311085 | |
| 3 | Geri Lamaj | Gjeqozë | Privat sh.p.k | 0682345098 | |
| 4 | Nuçi Gllava | Gjinogor | Ish Fshat | 0682409147 | |
| 5 | Armand Ahmetaj | [illegible] Patos | V/Këshilli | 0692844474 | |
| 6 | Deshmiri Lamaj | Gjeqozë | Shtëpiake | 0682345098 | |
| 7 | Denada Lamaj | Gjinogor | Shtëpiake | 0694596145 | |
| 8 | Agim Mazaj | Sinjoc | Administrator | 0692036282 | |
| 9 | Rafaela Veba | Patos | SEKRETARE KESHILLI | 069219918[illegible] | |
| 10 | Luizaura Gropa | Patos | Koordinatore informimit | 0699490612 | |
| 11 | Arlind Rusto | Zhamnez | Arkitekt | 0677191713 | |
| 12 | | | | | |

*Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008" Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përjashtohet nga*

Ruzhdie më, 21.07.2023

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PATOS**

**LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:**

**RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026" DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024"**

| Nr | Emër Mbiemër | Qyteti / Fshati | Profesioni/ Pozicion | Nr. Kontakti | Firma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Qerem Meçaj | Gjinogor. | [signature] | — | [signature] |
| 2 | Hysniet Medulaj | Gjinogor | Fermer. | — | [signature] |
| 3 | Teuta Medulaj | Gjynogor | Fermer | — | [signature] |
| 4 | Sabri Myftarc | Rozhdijë | Kryeplak | — | [signature] |
| 5 | Suela Hoxhaj | Patos | Fizikane | 0694407813 | [signature] |
| 6 | Liliana Mesutaj | Ruzhdie | ~~Keshilltare~~ mesuese | 0684849004 | [signature] |
| 7 | Njazi Muçaj | Gjinogore | Ferma | — | [signature] |
| 8 | Belul Muçaj | Gjinogore | Ferma | — | [signature] |
| 9 | Kondimin Muçaj | Gjinogore | Ferma | — | [signature] |
| 10 | Bashkim Muçaj | Gjinogore | Ferma | — | [signature] |
| 11 | Fatos Gllavaj | Gjinogor | -//- | — | [signature] |
| 12 | Arben Anopoj | Gjinogor | -//- | — | [signature] |

*Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008" Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përjashtohet nga*

Ruzhdie më, 21.07.2023

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PATOS**

**LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:**

**RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026" DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024"**

| Nr | Emër Mbiemër | Qyteti / Fshati | Profesioni/ Pozicion | Nr. Kontakti | Firma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dylber Lagji | Gjinogaro | Insp. taftive | 0692123510 | [signature] |
| 2 | Fabio Myrtaj | Rushdie | Rojë Mjeshe | | [signature] |
| 3 | Veip Kamberaj | Ruzhdie | KVR | 0684347884 | [signature] |
| 4 | Enkelejola Agaj | Gjinogose | mesuese | | [signature] |
| 5 | Erald Sepeli | Zharrëz | Ekonomist | 0693583350 | [signature] |
| 6 | Shkelqim Agiraj | Patos | Sekretari Pergjithshem | 0683065343 | [signature] |
| 7 | Astrit Myftaj | Ruzhdie | Fermer | – | [signature] |
| 8 | Kaçi Selmani | Sieqe | Fermer | | [signature] |
| 9 | Xhemil Begë | Patos | sp. pyjeve | 0676291050 | [signature] |
| 10 | Arben Shpelldaj | Patos | P. E. Cicile | 0696879398 | [signature] |
| 11 | Orges Golloshi | Patos | Dr. Bujqësisë | 0693654661 | [signature] |
| 12 | Antol Hoxha | Patos | Dr. Agjensisë Shebimeve. | 0687684770 | [signature] |

*Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008" Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përjashtohet nga*

Ruzhdie më, 21.07.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:

**RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026" DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024"**

| Nr | Emër Mbiemër | Qyteti / Fshati | Profesioni/ Pozicion | Nr. Kontakti | Firma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Estila Myrtaj | Patos | Këshilltare | 0699705092 | [signature] |
| 2 | MYFTAR SORRAJ | Sioccë | KRYETAR Pleqësie | 0682453149 | [signature] |
| 3 | Hekuri Qosaj | Kasnic | Kryetar Fshati | 0682468175 | [signature] |
| 4 | Bequr Muçaj | Gjinoqarë | Banor | 0689571278 | [signature] |
| 5 | Seit Azoporj | Gjinoqarë | Banor | 0693680784 | [signature] |
| 6 | Besim Muçaj | Gjinoqarë | Banor | — | |
| 7 | Ashim Metaj | Gjinoqare | Fermer | 0692307797 | [signature] |
| 8 | BASHKIM MUÇAJ | Gjinoqare | Mësues | 0699282577 | [signature] |
| 9 | Ladimir Muçaj | Gjinoqare | Fermer | 0685620992 | [signature] |
| 10 | Shaban Sanaj | Drenije | Kr. Pleqësie | 0682681830 | [signature] |
| 11 | VIKTOR MUÇAJ | MASHKULLOR | FERMER | 0693011901 | [signature] |
| 12 | Dine Selimaj | Siqec | Termohidraulik | 0685237069 | [signature] |

*Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008" Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, letrare ose artistike. Përjashtohet nga*

Ruzhdie më, 21.07.2023

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PATOS**

**LISTË PREZENCË PËR DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:**

**RISHQYRTIMIN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026" DHE KËRKESAVE BUXHETORE PËR VITIN 2024"**

| Nr | Emër Mbiemër | Qyteti / Fshati | Profesioni/ Pozicion | Nr. Kontakti | Firma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | [illegible] | Moshkuqe | Bujqi | 0699464074 | [signature] |
| 2 | Bledar Murati | moshkullar | Bujqi | 0699464074 | [signature] |
| 3 | [illegible] | Patos | D/Financë | 0683277... | [signature] |
| 4 | Boreta Murati | Patos | D/Urbanistike, Projekte Sherbime | 0693257208 | [signature] |
| 5 | Suzana Hysenaj | Patos | Koord. Konsultimi | 0694891460 | [signature] |
| 6 | | | | | |
| 7 | | | | | |
| 8 | | | | | |
| 9 | | | | | |
| 10 | | | | | |
| 11 | | | | | |
| 12 | | | | | |

*Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008" Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.*